



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:202830

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05766659

KPPP.nr.1979/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “ALTPRO” D.O.O., me seli në Velika Cesta nr.41, Zagreb, Kroaci, përfaqësuar sipas autorizimit nga Hazer Susuri, avokat nga Prizreni, kundër debitorit N.T.SH. “H-Projekt”, me NUI: 811203611, me seli në Gjilan, rruga “Gazmend Zajmi”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.335/23 të datës 16.08.2023, të Përmbartuesit Privat Kushtrim M. Musa, me seli në Gjilan, jashtë seancës me datë 31.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i pa bazuar prapësimi i debitorit N.T.SH. “H-Projekt” dhe Urdhri Përmbartimor P.nr.335/23 i datës 16.08.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Kushtrim M. Musa, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.335/23 të datës 16.08.2023, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës Nr.234/1/1 të datës 13.01.2023, me të cilin e ka detyruar debitorin që në emër të përmbushjes së obligimeve nga fatura, t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 60,286.00 €, me kamatën prej 8%, nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri me pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore dhe ato të përpilimit të propozimit për përmbartim në shumë prej 208.00 €, nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë, me bartjen e mjeteve financiare nga llogaria bankare e debitorit në llogarinë e veçantë bankare të kreditorit, me regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të debitorit dhe pagesën e borxhit nga shitja e këtyre sendeve.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se fatura e cila është objekt i kësaj procedure përmbarimore nuk është pranuar asnjëherë nga ana e debitorit, po ashtu shuma e kërkuar nga ana e kreditorit nuk është e saktë, sepse kohë pas kohe janë paguar disa shuma por nuk e dinë saktë se sa ka paguar, sa i përket pranimit të faturës përmes postës ka deklaruar se e njëjta i është kthyer përfaqësuesit të autorizuar të kreditorit gjë e cila vërtetohet nga dëshmia e postes e datës 05.07.2023. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj prapësimin e debitorit ndërsa urdhrin përmbarimor ta shfuqizoj.

Kreditori në përgjigje në prapësim, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka theksuar se fatura i plotëson kushtet ligjore për përmbarim, sepse faturën lëndore debitori e ka pranuar me datë 29.06.2023, e cila vërtetohet edhe përmes dëshmisë së postes rekomande nr.5204878, e nënshkruar nga debitori me datë 27.06.2023, dhe me këtë është plotësuar kushti i pranimit të faturës nga ana e debitorit, sa i përket pretendimit se shuma nuk është e saktë, ka deklaruar se shuma që kërkohet është e saktë të njëjtën debitori nuk ka përmbushur ndaj kreditorit edhe pas komunikimeve që ka pasur mes kreditorit dhe debitorit. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarimor ta vërtetoj.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet, për arsye si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se: *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “.* Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se: *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti, përkatësisht Fatura nr. Nr. 234/1/1 e datës 13.01.2023, mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për arsye se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet se fatura në fjalë është dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe se e

njëjta është pranuar nga debitori si në përmbajtje ashtu edhe për nga lartësia, për arsye se faturave ju mungon nënshkrimi apo vula e pranimi të debitorit.

Gjykata, ka vlerësuar edhe dëftesën për pranimin e dërgesës së datës 23.06.2023, të cilën kreditori ia ka bashkangjitur propozimit për përmbartim dhe përmes së cilës pretendon se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri i është dorëzuar me rregull debitorit, mirëpo një dorëzim të tillë të faturës përmes postës gjykata nuk mund ta konsideroj si dorëzim të rregullt dhe pranim të faturës nga ana e debitorit, ngase nga shkresat e lëndës rezulton se fatura debitorit i është dorëzuar në postë nga ana e avokatit dhe jo kreditorit, veprim ky i ndërmarr me qëllim të tentimit të krijimit të kushteve për iniciimin e procedurës përmbartimore, çka nënkupton se nuk ka pasur dorëzim të rregullt të faturës nga ana e kreditorit. Për më tepër, nga shkresat e lëndës rezulton se debitori pas pranimi të dërgesës postare me përmbajtje të faturave të dërguar nga avokati i kreditorit, përmes dëftesës për pranimin e dërgesës me numër serik 222012023619285, të datës 05.07.2023, të njëjtën e ka kthyer tek përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumentet mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilit Përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, nuk ka tipare të përmbartueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit duhet të anulohet.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1979/23, datë 31.05.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.